



Ftesë për trajnim

BUXHETIMI STRATEGJIK, PLANIFIKIMI FINANCIAR EFEKTIV DHE EKZEKUTIMI

Procesi buxhetor nga plani në zbatim

Trajnimi mbahet në Durrës nga data 10 – 13 Prill 2026

Trajnimi është i dedikuar për Zyrtarët Kryesorë Financiar, Zyrtarët Financiar, Auditor të organizatave buxhetore të nivelit qendror dhe lokal dhe të gjithë ata që dëshirojnë ti rrisin njohuritë e tyre në temën e cekur. Ka për qëllim të forcojë kapacitetet e tyre në menaxhimin e financave publike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikrat më të mira të menaxhimit të financave publike.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre përmes ligjëratis dhe punës praktike dhe elaborimit të secilit komponent kyç në kuadër të moduleve të përzgjedhura në këtë trajnim.

Trajnimi do të organizohet në këto module:

1. Buxhetimi Strategjik

Ky modul trajton mënyrën se si institucionet mund të lidhin objektivat e tyre afatgjata me alokimet buxhetore përmes një qasjeje strategjike. Diskutohet rëndësia e përcaktimit të prioriteteve, integrimi i politikave sektoriale në planin financiar dhe roli i analizës së kostos dhe përfitimit në marrjen e vendimeve të informuara.

2. Planifikimi Financiar Efektiv

Ky sesion fokusohet në hapat kyç të hartimit të një plani financiar të qëndrueshëm dhe të realizueshëm, bazuar në parashikime të sakta të të ardhurave dhe shpenzimeve. Pjesëmarrësit do të njihen me teknikat e parashikimit financiar, analizën e rreziqeve dhe mënyrën e koordinimit ndërmjet departamenteve për të siguruar konsistencë dhe realizim të objektivave buxhetore.

3. Ekzekutimi i Buxhetit – Procesi nga Planit në Zbatim

Ky modul shpjegon se si kalohet nga një plan buxhetor teorik në një ekzekutim praktik dhe efektiv. Do të trajtohen procedurat e alokimit të fondeve, ndarja mujore e buxhetit apo nën-alokim, menaxhimi i cash flow dhe mekanizmat për monitorimin dhe raportimin gjatë vitit buxhetor. Gjithashtu theksohet rëndësia e fleksibilitetit dhe e përshtatjes së buxhetit me kushtet reale gjatë zbatimit.

4. Zbatimi i Standardeve të Kontabilitetit në Menaxhimin e të Hyrave, Pagesave, Aseteve Kapitale Financiare dhe Jo Financiare

Ky modul synon të forcojë kapacitetet e stafit financiar për të aplikuar standardet e kontabilitetit në mënyrë të saktë dhe të konsistente gjatë menaxhimit të ciklit të plotë financiar – nga të hyrat dhe pagesat, deri te administrimi i asetëve kapitale financiare dhe jo financiare. Pjesëmarrësit do të njihen me praktikën më të mirë për regjistrimin, klasifikimin, vlerësimin dhe raportimin sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit (p.sh. IPSAS). Gjithashtu, trajtohen sfidat praktike në përputhje me standardet, përmirësimi i kontrollit të brendshëm dhe rëndësia e informacionit financiar të besueshëm për vendimmarrje efektive.

5. Menaxhimi i Kontratave

Ky modul ofron njohuri praktike mbi menaxhimin e kontratave në kuadër të institucioneve publike, përfshirë lidhjen, ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave të prokurimit dhe të shërbimeve. Do të trajtohen fazat kryesore të ciklit të kontratës – nga përgatitja e termave të referencës, vlerësimi dhe nënshkrimi i kontratave, deri te menaxhimi i zbatimit, monitorimi i performancës dhe raportimi.

Pjesëmarrësit do të njihen me praktikën e mirë për shmangien e riskut kontraktual dhe ruajtjen e kontrollit financiar gjatë zbatimit të kontratave në përputhje me kornizën ligjore dhe buxhetore.

Zhvillimi i temave të trajnimit:

Trajnimi do të mbahet nga z. Nysret Koca, një ekspert i mirënjohur në fushën e menaxhimit të financave publike. Me mbi 20 vite përvojë profesionale në Ministrinë e Financave, z. Koca sjell një bagazh të pasur njohurish dhe praktikash të avancuara në administrimin financiar në sektorin publik.

Ai posedon një numër të konsiderueshëm certifikatash kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat: Planifikim Strategjik; Planifikim dhe Menaxhim Buxhetor; Prokurim Publik; Menaxhim Projektsh; Parashikim i Rrjedhës së Parasë; Raportim Financiar; Menaxhim dhe Kontroll Financiar, etj.

Përvoja dhe ekspertiza e tij do t'i japin këtij trajnimi vlerë të shtuar, me fokus në aplikimin praktik të njohurive në institucionet publike.

Çmimi për pjesëmarrje në trajnim është 599 €.

Në çmim përfshihet: trajnimi, materiali i trajnimit, certifikata, transporti dhe akomodimi në hotel.

Të gjithë të interesuarit duhet që rezervimin e pjesëmarrjes në trajnim ta bëjnë më së largu deri me **9 prill 2026**, numri i pjesëmarrësve i kufizuar.

Për informata dhe rezervime kontaktoni:

Tel: 044/100-260,
email: prudencia.consulting@gmail.com